

**DELOITTE AUDIT ALBANIA SH.P.K.**

**Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

**PERMBAJTJA**

<b>RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR</b>	<b>i-iii</b>
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT AKSIONAR</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE</b>	<b>4</b>
<b>SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>5-16</b>


**Deloitte Audit Albania Sh.p.k.**  
**Pasqyra e pozicionit financiare më 31 Dhjetor 2021**  
*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)*

Nr Përshkrimi i elementeve	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	120,012,030	22,297,472
Llogari të arkëtueshme	5	24,585,442	63,948,406
Aktive të tjera afatshkurtra	6	347,336	265,417
Kapital i nenshkruar i papaguar		100,000	100,000
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>145,044,808</b>	<b>86,611,295</b>
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive materiale	7	7,063,144	4,696,406
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>7,063,144</b>	<b>4,696,406</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>152,107,952</b>	<b>91,307,701</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrime</b>			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	8	24,233,452	19,763,380
Detyrime të pagueshme tatimore	9	10,328,178	4,998,174
Shpenzime të përlogaritura	10	7,356,929	60,613
<b>Detyrime totale</b>		<b>41,918,559</b>	<b>24,822,167</b>
<b>Kapitali dhe Rezervat</b>			
Kapitali i nenshkruar	11	100,000	100,000
Fitimi i pashpërndarë		66,385,533	58,594,901
Fitimi i vitit		43,703,860	7,790,632
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>110,189,393</b>	<b>66,485,533</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>152,107,952</b>	<b>91,307,701</b>

*Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 15 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**Administratori/ Drejtues ekzekutiv**

**Olindo Shehu**

  
**DELOITTE AUDIT ALBANIA**  
 Ad. Pr. "Fakri Konica", Ndërtesa Nr. 6, Hyrja Nr. 7, 1010 Tiranë  
 TIRANA - ALBANIA  
 MPT: L 41709002 H  
 Tel: 044517920

**Hartuesi**

**Deloitte Audit Albania Sh.p.k**



(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

Nr Përshkrimi i elementëve	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>Të ardhurat</b>			
Të ardhurat nga shitja e shërbimeve	12	165,421,976	116,342,306
Të ardhura të tjera	13	116,527	-
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>165,538,503</b>	<b>116,342,306</b>
<b>Shpenzimet operative</b>			
Shërbime dhe materiale të konsumuara	14	(38,793,092)	(32,926,497)
Shpenzime te personelit	15	(62,658,945)	(58,704,496)
Shpenzime amortizimi	7	(1,593,370)	(1,361,444)
Shpenzime të tjera	16	(7,193,911)	(12,176,066)
Komisione bankare		(314,759)	(361,757)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(110,554,077)</b>	<b>(105,530,258)</b>
<b>Fitimi nga veprimtaria kryesore</b>		<b>54,984,426</b>	<b>10,812,048</b>
<i>Humbje neto nga kursi / këmbimit</i>		(2,888,173)	(66,622)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>52,096,253</b>	<b>10,745,425</b>
Shpenzimi i tatim fitimit		(8,392,393)	(2,954,793)
<b>Fitimi neto financiar</b>		<b>43,703,860</b>	<b>7,790,632</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>		-	-
<b>Totali i fitimit dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>43,703,860</b>	<b>7,790,632</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Deloitte Audit Albania Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Kapitali i nenshkruar	Fitimet e pashperndara	Totali
<b>Pozicioni më 1 janar 2020</b>	<b>100,000</b>	<b>58,594,901</b>	<b>58,694,901</b>
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:	-	-	-
Fitimi i vitit	-	7,790,632	7,790,632
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>-</b>	<b>66,385,533</b>	<b>66,485,533</b>
Totali i transaksioneve për pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2020</b>	<b>100,000</b>	<b>66,385,533</b>	<b>66,485,533</b>
<b>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të vitit:</b>			
Fitimi i vitit	-	43,703,860	43,703,860
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Totali i transaksioneve për pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2021</b>	<b>100,000</b>	<b>110,089,393</b>	<b>110,189,393</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

(te gjitha shumat jane ne LEK, perveç kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:</b>			
Fitimi para tatimit		52,096,253	10,745,425
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>			
Shpenzime amortizimi	7	1,593,370	1,361,444
Provizione për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme	5	1,777,693	7,949,268
Humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	13	26,291	-
<b>Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit para rregullimeve në kapitalin punues</b>		<b>55,493,607</b>	<b>20,056,138</b>
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit			
Rënie/(Rritje) të llogarive të arkëtueshme	5	37,585,271	2,416,466
Rënie/(Rritje) i aktiveve të tjera afatshkurtra	6	(81,919)	38,958
Rritje/(Rënie) në të pagueshme ndaj furnitorëve	8	4,470,072	(29,551,551)
Rritje/(Rënie) në detyrime të pagueshme tatimore	9	1,410,945	465,635
Shpenzime të përlogaritura	10	7,296,316	60,613
<b>Mjete monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit</b>		<b>106,174,292</b>	<b>(6,513,741)</b>
Tatim fitimi i paguar		(4,473,334)	-
<b>Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit</b>		<b>101,700,958</b>	<b>(6,513,741)</b>
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit			
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	7	(4,102,927)	(1,377,546)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	13	116,527	-
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit</b>		<b>(3,986,400)</b>	<b>(1,377,546)</b>
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>			
		-	-
<b>Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim		97,714,558	(7,891,287)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	4	22,297,472	30,188,759
		<b>120,012,030</b>	<b>22,297,472</b>

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Shoqëria Deloitte Audit Albania Sh.p.k., themeluar si Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar më datë 23/04/2014, me NUIS L41709002H ushtron aktivitetin e saj në fushën e "Kontabilitetit, mbajtje llogarish e pasqyrash financiare dhe veprimtari auditimi. Aktivitete të tjera biznesi.", me adresë "Rruga Faik Konica, Ndertesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010,Tirane".

Kapitali i shoqërisë sipas aktit të themelimit ka vlerën prej 100,000 LEK dhe përbëhet nga kontributi i Ortakeve :

- Olindo Shehu 51 % të kapitalit të shoqërisë
- Deloitte Central Europe Holdings Limited 49 % të kapitalit të shoqërisë

Shoqëria Deloitte Audit Albania Sh.p.k. , ka si përfaqësues ligjor :

- Znj Enida Cara
- Z. Gregory Paul Rossouw
- Z.Olindo Shehu

Në 31 Dhjetor 2021 shoqëria ka deklaruar 56 punonjës (31 dhjetor 2020: 44 punonjës).

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

Pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 Nr. 25/2018 Date 10.05.2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", duke aplikuar standardet kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe të miratuara nga Ministri i Financave.

Monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë është LEK.

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Keto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në Lek Shqiptar "LEK".

### **2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

## 2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

### 2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

Vlerësimi kontabël më i rëndësishëm për kompaninë është ai që lidhet me rekuperueshmërinë e llogarive të arkëtueshme. Administratorët e kompanisë klasifikojnë si indikacion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme momentin kur marrëdhëniet e biznesit me klientin janë ndërprerë dhe kanë filluar proceset gjyqësore që lidhen me klientin. Për qëllime të hartimit të pasqyrave financiare për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2021, administratoret e shoqërisë kanë konsideruar ditëvonesat në arkëtimin e shërbimeve si indikacion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme të shoqërisë. Ky ndryshim në vlerësimet kontabël është njohur prospektivisht në përputhje me kërkesat e SKK-së.

## 3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhë të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me EURO me 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
EURO (EUR)	120,76	123.70
USD (USD)	106,54	100.84

### 3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivative përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtare të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivative maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset monetare të aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.



### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 4.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Ndërprerja e marrëdhënies së biznesit me klientin, vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose hapja e çështjeve gjyqësore në ngarkim të klientit konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Vlera e drejtë*

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivitetit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, e kërkesave për t'u arketuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

#### *i. Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndarë (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) dhe janë pasqyruar neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

##### ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të aktive afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur e pronave, pajisjeve dhe makinerive janë rishikuar në datën e raportimit.

Kategoria e aktivitet	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Pajise informatike e sisteme informacioni	Mbi vlerën e mbetur	25%
Pajise zyre dhe mobilje	Mbi vlerën e mbetur	20%
Te tjera AAM	Mbi vlerën e mbetur	20%

#### 3.4 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet jo materiale, të cilat përbëhen tërësisht nga programe kompjuterike, njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka. Amortizimi shpërndahet duke përdorur metodën e amortizimit linear. Norma e amortizimit e përdorur për aktivitet afatgjata jo materiale është 15%. Jeta e dobishme e vlerësuar dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese vjetore, duke njohur në periudhat pasuese efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësimet kontabël.

#### 3.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur produktet dhe shërbimet janë përfunduar, kryer, në përputhje me SKK 8 Të ardhurat.

Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri, të ardhurat e lidhura me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- Shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do të bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat gjenerohen nga shërbimet e ofruara klientëve bazuar në kontratë dhe njihen sipas çmimeve për njësi për çdo kontratë të realizuar.

### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.6 Shpenzime për personelin

##### *Kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore*

Gjate aktivitetit të saj normal, Shoqëria kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet e sigurimit shoqërore dhe shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

#### 3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimit. (nuk ka depozita)

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, humbjet nga kurset e këmbimit, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka). (nuk ka hua me interes, dhe dif e kursit janë të shpenzimeve të tjera)

#### 3.8 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës. Përqindja e tatimit fitimit në fuqi gjatë vitit 2021 ishte 15% (2020: 15%).

#### 3.9 Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

**4. Aktivet Monetare**

Aktivët monetarë përbëhen nga paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>Arka</b>	-	5,332
- Në Lek	-	1,390
- Në monedhë të huaj	-	3,942
<b>Llogari rrjedhëse</b>	<b>120,011,415</b>	<b>22,276,240</b>
- Në Lek	2,141,739	2,627,895
- Në monedhë të huaj	117,869,676	19,648,344
<b>Llogari të tjera rrjedhëse</b>	<b>615</b>	<b>15,900</b>
<b>TOTALI</b>	<b>120,012,030</b>	<b>22,297,472</b>

**5. Llogari të arkëtueshme**

Të arkëtueshmet përbëhen nga klientët të cilët janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Klientë - palë të treta	20,424,774	20,860,916
Klientë – palë të lidhura	13,905,468	51,054,597
Provizione për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme	(9,744,800)	(7,967,107)
<b>TOTALI</b>	<b>24,585,442</b>	<b>63,948,406</b>

Provizionet për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme detajohen si më poshtë vijon:

Gjendja më 1 janar 2020	-
Shtesa	7,967,107
Rimarrje	-
Humbje	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>7,967,107</b>
Shtesa	1,767,648
Rimarrje	10,045
Çregjistrim i provizioneve	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>9,744,800</b>

**6. Aktive të tjera afatshkurtra**

Aktivët e tjera afatshkurtra kanë të bëjnë me parapagimin e bërë për sigurimin e punonjësve pranë Intersig.

Më datë 31 dhjetor 2021 ato kanë një vlerë prej 347,336 Lek, ndërsa me 31 dhjetor 2020 vlera e tyre ishte 265,417 Lek.

## 7. Aktivet Afatgjata

Aktive Materiale	Paisje Zyre	Mjete transporti	Pajisje zyre dhe informatike	Totali
<b>Kosto</b>				
Gjendja me 1 janar 2020	275,877	2,519,640	5,563,889	8,359,406
Shtesa	-	-	1,377,546	1,377,546
Pakësime	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>275,877</b>	<b>2,519,640</b>	<b>6,941,435</b>	<b>9,736,952</b>
Shtesa	-	-	4,102,927	4,102,927
Pakësime	-	-	(513,842)	(513,842)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>275,877</b>	<b>2,519,640</b>	<b>10,530,519</b>	<b>13,326,037</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
Gjendja ne 01 janar 2020	(123,934)	(1,573,599)	(1,981,569)	(3,679,102)
Amortizimi për periudhën	(30,389)	(189,208)	(1,141,847)	(1,361,444)
Pakësimet	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(154,323)</b>	<b>(1,762,807)</b>	<b>(3,123,416)</b>	<b>(5,040,546)</b>
Amortizimi për periudhën	(24,311)	(151,367)	(1,417,692)	(1,593,370)
Pakësimet	-	-	371,024	371,024
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>(178,634)</b>	<b>(1,914,174)</b>	<b>(4,170,084)</b>	<b>(6,262,892)</b>
<b>Vlera kontabel neto më 31 dhjetor 2020</b>	<b>121,555</b>	<b>756,833</b>	<b>3,818,018</b>	<b>4,696,406</b>
<b>Vlera kontabel neto më 31 dhjetor 2021</b>	<b>97,244</b>	<b>605,466</b>	<b>6,360,435</b>	<b>7,063,145</b>

## 8. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Të pagueshmet ndaj furnitorëve janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Furnitorë palë të treta	216,456	-
Furnitorë palë të lidhura	24,016,996	19,763,380
<b>TOTALI</b>	<b>24,233,452</b>	<b>19,763,380</b>

**9. Detyrime të pagueshme tatimore**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	1,137,209	926,504
Tatimi në burim	1,364,602	801,422
Tatim mbi fitimin	4,839,903	920,844
Tatim mbi të ardhurat personale	561,593	616,954
TVSh e pagueshme	2,424,871	1,732,450
<b>TOTALI</b>	<b>10,328,178</b>	<b>4,998,174</b>

**10. Shpenzime të përllogaritura**

Gjëndja e llogarisë shpenzime të përllogaritura më 31 dhjetor 2021 është 7,356,929 Lek (më 31 dhjetor 2020 gjëndja ishte 60,613 Lek). Ky zë përfshin të pagueshme për shërbime të marra gjatë 2021 por të pafaturuara deri më 31 dhjetor 2021 në vlerën 7,356,929 Lek.

**11. Kapitali i pronarit**

Kapitali i shoqërisë sipas aktit të themelimit ka vlerën prej 100,000 LEK dhe përbëhet nga kontributi i Ortakeve

- Olindo Shehu 51 % të kapitalit të shoqërisë
- Deloitte Central Europe Holdings Limited 49 % të kapitalit të shoqërisë

**12. Të ardhura nga shitja e shërbimeve**

Shoqëria gjatë vitit 2021 ka realizuar të ardhura nga shitja e shërbimeve të kryera për llogari të klientëve të kontraktuar në vlerën 165,421,976 Lek (2020: 116,342,306 Lek) që kanë të bëjnë me kryerjen e shërbimeve të auditimit të pasqyrave financiare.

**13. Të ardhura të tjera**

Shoqëria gjatë vitit 2021 ka realizuar edhe të ardhura të tjera që lidhen kryesisht me shitjen e aktiveve afatgjata materiale (AAM) në vlerën 116,527 Lek.

Rezultati i shitjes së AAM detajohet si më poshtë vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga shitja e AAM	116,527	-
Vlera kontabël neto e AAM të shitura (shënimi 7)	(142,818)	-
<b>(Humbja)/Fitimi nga shitja e AAM</b>	<b>(26,291)</b>	<b>-</b>

**14. Shërbime dhe materiale të konsumuara**

Shërbimet dhe materialet e konsumuara kanë lidhje me shpenzimet e kryera për qëllim realizimin e shërbimit për klientët e kontraktuar të detajuar si më poshtë vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime manaxheriale dhe IT	30,257,005	14,733,165
Shërbime nga nënkontraktorë	3,894,500	10,495,161
Tarifa anetaresimi	2,062,575	954,933
Tarifa provimi	1,274,370	1,039,721
Shpenzime kancelarie	540,880	349,945
Shpenzime telefoni	370,315	464,973
Shpenzime udhëtimi	163,595	3,957,303
Shpenzime noteriale	122,040	155,645
Shpenzime transporti brenda vendit	107,782	775,651
<b>TOTALI</b>	<b>38,793,092</b>	<b>32,926,497</b>

**14. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit janë të detajuara si më poshtë vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Paga dhe shpërblime	56,056,883	52,262,425
Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	6,602,062	6,442,071
<b>TOTALI</b>	<b>62,658,945</b>	<b>58,704,496</b>

**15. Shpenzime të tjera**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Qira	1,470,890	1,484,820
Shpenzime provigjoni	1,777,693	7,967,107
Shpenzime për personelin	1,176,934	1,069,822
Shpenzime përfaqësimi	1,443,256	828,149
Shpenzim mirembajtje	984,898	769,843
Shitje asetesh	142,819	-
Shpenzime sigurimi	61,198	21,206
Shpenzime të tjera	136,223	146,952
<b>TOTALI</b>	<b>7,193,911</b>	<b>12,176,066</b>

**16. Shpenzime tatim fitimi**

Përqindja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 sipas legjislacionit fiskal shqiptar është 15% (15% për vitin 2020).

Të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen si vetëdeklarime deri në momentin që shqyrtohen dhe vlerësohen nga autoriteti i taksave.

**16. Shpenzime tatim fitimi (vazhdim)**

Shpenzimet e panjohura përbëhen kryesisht nga shpenzime të pa mbeshtetura me dokumentacion të rregullt tatimor dhe provigjonet që janë subjekt i gjykimit të shoqërisë.

Në vitin 2021 Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël dhe një fitim fiskal (në vitin 2020 fitim kontabël dhe një fitim fiskal) si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>Fitimi i vitit para tatimit</b>	<b>52,096,253</b>	<b>10,745,425</b>
Shtesë: Shpenzime të pazbritshme	3,853,037	8,953,196
<b>Fitimi fiskal i vitit</b>	<b>55,949,290</b>	<b>19,698,621</b>
Tatim fitimi me 15% (2020: 15%)	8,392,393	2,954,793
<b>Tatim fitimi i parapaguar</b>	<b>3,552,490</b>	<b>1,933,533</b>
Tatim fitimi për t'u paguar/(arkëtuar)	4,839,903	1,021,260

**17. Transaksionet me palët e lidhura**

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve ose detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pa konsideruar nëse mbahen ndalesa. Një palë e lidhur është një palë e cila kontrollon, është e kontrolluar nga ose është nën të njëjtin kontroll me, njësinë; ka një interes në njësi e cila jep ndikim domethenës mbi njësinë; ose ka kontroll mbi njësinë, është një ortak i njësisë; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi është pjesëmarrëse; ose është pjesë e personelit kryesor të drejtimit të njësisë ose të shoqërisë mëmë (përfshirë anëtarët e ngushtë të familjes të secilit prej individëve të referuar më sipër).

Shoqëria ka transaksione me palët e lidhura që vijnë si më poshtë:

	Për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2021	Për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2020
<b><u>Pasqyra e Pozicionit Financiar</u></b>		
Të drejta të arkëtueshme nga transaksionet me palët e lidhura	13,905,468	51,054,597
<b>Totali i të arkëtueshmeve nga transaksionet me palët e lidhura</b>	<b>13,905,468</b>	<b>51,054,597</b>
Llogaritë e pagueshme – palët e lidhura	24,016,996	19,763,380
Shpenzime të përlogaritura – palët e lidhura	7,356,929	60,613
<b>Totali i detyrimeve me palët e lidhura</b>	<b>31,373,925</b>	<b>19,823,993</b>
<b><u>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse</u></b>		
Të ardhura nga shërbimet profesionale	86,827,958	28,543,025
<b>Të ardhura totale nga palët e lidhura</b>	<b>86,827,958</b>	<b>28,543,025</b>
Shpenzime për shërbime informatike	12,639,149	9,799,515
Shpenzime për shërbime menaxheriale	9,906,536	4,933,650
Shpenzime për shërbime profesionale	3,891,101	6,338,022
Shpenzime për royalty	7,711,320	4,691,446
Shpenzime trainimi	-	314,555
<b>Shpenzimet totale nga palët e lidhura</b>	<b>34,148,106</b>	<b>26,077,188</b>



**18. Ngjarje pas datës së bilancit**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të ishte e nevojshme të paraqitshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

**19. Angazhimet dhe pasiguritë**

Nuk ka angazhime dhe pasiguri që kerkojne paraqitje ose korrjgjim në pasqyrat financiare.

**20. Administrimi i rrezikut financiar**

**a) Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normave të interesit është rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumentave financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave lidhur me aktivet ndryshojnë nga maturitetet e interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për keto aktive. Hapësira e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar për nje instrument financiar tregon se në çfarë niveli Shoqëria eshte e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut.

**b) Rreziku i kredisë**

Shoqëria nuk ka ndonjë ekspozim të madh ndaj rrezikut të kredisë, i cili mund të ndikojë në pozicionin financiar apo performancën e Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021.

**c) Rreziku i likuiditetit**

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të ndjeshme ndaj rrezikut të likuiditetit. Detyrimet financiare limitohen në llogari të pagueshme gjatë rrjedhës normale të aktivitetit.

INVENTARI I ASETETEVE TE PA LUAJTSHME  
31.12.2021

<u>Subjekti</u>	Deloitte Audit Albania Shpk
<u>NIPT-I</u>	L41709002H
<u>Aktiviteti</u>	Shërbime auditimi
<u>Adresa Vep.</u>	Rr. Faik Konica, Nd.6, H.7

Deloitte Audit shpk nuk ka Inventar te Aseteve te paluajtshme me 31.12.2021

Administratori  
Olindo Shehu



**Subjekti: Deloitte Audit Albania sh.p.k**

Inventari automjeteve ne pronesi te Deloitte Audit Albania sh.p.k 2021

NR	Lloji Automjeteve	Kapacitet	Targa	Vlera
1	Octavia Ambition 1.6 TDI auto	4+1	AA649MA	605,466
<b>Shuma</b>				<b>605,466</b>

**Perfaqesuesi i personit juridik**

( Olindo Shehu)

(Emer, Mbiemer, Firme, Vule)

**DELOITTE AUDIT ALBANIA**  
Ad. Rr. "Faik Konica", Ndërtesa Nr. 6, Hyrja Nr. 7, 1010 Tiranë  
TIRANA - ALBANIA  
NIPT: L 41709002 H  
Tel: 044517920